



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1000/5 Prot.

Tiranë, më 02 / 10 / 2019

V E N D I M

Nr. 135, Datë 02 / 10 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 95 Regjistri, datë 05.08.2019, të subjektit ankues, P. S, kundër Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), me pretendimin për diskriminim për shkak të *“përkatësisë në një grup të veçantë”*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, P. S, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e tij, e cila konsiston si më poshtë citohet:

¹ Bazuar në shkresën me nr.extra prot., datë 21.11.2011 të Institutit të Përndjekurve Politikë, subjekti ankues ka fituar statusin e të përndjekurit politik.

²Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e Bordit të Administrimit të Universiteteve Publike”, një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët paraqesin tri kandidatura. Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidatëve të paraqitur nga studentët, të cilët duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Lidhur me sa mësipër, studentët e vitit të tretë Financë-Kontabilitet, Fakulteti Ekonomik, Universiteti Shkodër, kanë propozuar të përfaqësohen nëpërmjet kandidaturës së P. S.

Në vijim të procedurës për votimin e kandidatit të propozuar nga studentët është ngritur Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, i cili ka miratuar 5 kandidatura. (P.S (ankuesi), A.P, N.Ç, S.B, T.P)

Bazuar në shkresën me nr.457 prot., datë 15.03.2019 “Vendim” të KIZ, rezulton se renditja e kandidatëve është si më poshtë:

- A.P është votuar me 151 pikë në total.
- N.Ç është votuar me 133 pikë në total.
- P.S (ankuesi) është votuar me 665 pikë në total.
- S.B është votuar me 8 pikë në total.
- T.P është votuar me 379 pikë në total.

Ankuesi pretendon se bazuar në pikëzimin më sipër dhe vlerësimin e KIZ, duhet të ishte shpallur ai fitues nga ana e Ministres së MASR-së, dhe jo kandidatura e renditur në vendin e dytë, pas tij, z.T.P, i cili nuk plotëson as kriteret e kërkuara për pozicionin si anëtar i Bordit Administrimit të Universiteteve Publike.

P. S ka pretenduar se nga ana e MASR është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë krahasuar me z.T.P dhe në bindjen e tij kjo gjë ka ardhur për shkak se ai i përket grupimit të të përndjekurve politikë, si dhe për shkak të mbështetjes që u ka dhënë studentëve në protestat e organizuara gjatë këtij viti kundër MASR-së.

Në përfundim të ankesës së tij, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e MASR-së dhe rivënien në vend të së drejtës së tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1000/4 prot., datë 09.08.2019 Komisioneri i ka kërkuar informacion Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë (MASR), lidhur me pretendimin e P. S.

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Me shkresën me nr.7913/1 prot., datë 03.09.2019 MASR ka dërguar parashtrimet e saj lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, MASR ka sqaruar se: *“Në pikën 6, të VKM nr.782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, përcaktohet specifikisht: “Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura. Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi”.*

MASR informon Komisionerin se, nëpërmjet shkresës me nr.322 prot., datë 14.01.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, me lëndë: “Për zbatimin e VKM nr.782, datë 26.12.2018”, iu është kërkuar institucioneve publike të arsimit të lartë, përfshirë edhe Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, zbatimi i këtij vendimi në përzgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve në Bordin e Administrimit.

Në zbatim të sa mësipër, MASR, citon se, kryerja e procedurave për përzgjedhjen e kandidaturave më të votuara nga studentët për përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit, është kryer nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), i ngritur pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. KIZ, në përfundim të procesit, nëpërmjet Vendimit nr.457, datë 15.03.2019, ka pasqyruar votat e marra për pesë kandidatët, duke vendosur përcjelljen pranë MASR, të tri kandidaturave më të votuara: P.S, T.P, A.P.

MASR, në vijim të përgjigjes thekson se: *“Në zbatim të pikës 6, të VKM nr.782, datë 26.12.2018, me Urdhrin nr.329, datë 07.06.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.155, datë 13.03.2019 “Për lirimimin nga detyra të anëtarëve të Bordit të Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe emërimin në detyrë të anëtarëve të rinj, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin”, Ministrja, ka zgjedhur një nga tri kandidaturat e paraqitura, atë të z.T.P. Vendimi i MASR, për emërimin e përfaqësuesit të studentëve në Bordin e Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, është bazuar plotësisht në Kodin e Procedurave Administrative (neni 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”) si dhe në pikën 6, të VKM nr.782, datë 26.12.2018, dhe si i tillë nuk ka diskriminuar kandidaturën e P. S”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pabarabartë të pretenduar nga subjekti ankues.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e Bordit të Administrimit të Universiteteve Publike”, në nenin 1 të tij, ka vendosur përcaktimin e kriterëve dhe procedurave transparente të përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, me qëllim garantimin e profesionalizmit, të pavarësisë dhe të integritetit etik të anëtarit të bordit.

Në pikën 6, të kësaj VKM-je, përcaktohet specifikisht se: *“Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura. Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi”.*

Neni 10 i kësaj VKM-je përcakton në mënyrë të qartë se, çdo kandidat për anëtar të bordit duhet të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit, në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.

Kriteret për t’u emëruar anëtar i bordit janë, si më poshtë vijon⁴:

- a) Të ketë integritet etik dhe profesional;
- b) Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- c) Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- ç) Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.

Njoftimi për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit, mënyra e vlerësimit të kandidatëve bazuar në kriteret e parashikuara në këtë vendim dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas parashikimit të bërë në nenin 7, të kësaj VKM-je.

⁴ Neni 11 i VKM-së.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, MASR nëpërmjet shkresës me nr. 322 prot., datë 14.01.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të saj, me lëndë: “Për zbatimin e VKM nr.782, datë 26.12.2018”, i ka kërkuar institucioneve publike të arsimit të lartë, përfshirë edhe Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, zbatimin e këtij vendimi në përzgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve në Bordin e Administrimit. Nëpërmjet kësaj shkrese, MASR-ja ka kërkuar nga KIZ, pranë universiteve publike, të përcaktojnë afatet për aplikim nga kandidatët, të vlerësojnë aplikantët për përmbushjen e kriterëve të vendimit, si dhe të hartojnë listat me kandidatët që plotësojnë kriteret për votim nga ana e studentëve.

Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si dhe anëtarët e tjerë të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Në vijim të zbatimit të sa mësipër, Ministri i MASR-së, nëpërmjet Urdhrit nr.41, datë 24.01.2019 “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, si dhe në mbështetje të pikës 7, të VKM nr.782, datë 26.12.2018, ka urdhëruar që: “Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të VKM nr.782, datë 26.12.2018 dhe shtojcës nr.1 të njoftimit, bashkëlidhur këtij Urdhri”.

Shtojca nr.1, bashkëlidhur këtij Urdhri “Njoftim për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, ka të specifikuar kërkesat e pranimit, në kërkesa të përgjithshme dhe kërkesa të veçanta që duhet të plotësojë kandidati. Kështu, në mënyrë të detajuar, janë përcaktuar:

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë;
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;
- Të ketë integritet etik dhe profesional;
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jetë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 Korrikut 1991, në kuptim të ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj;
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

Lidhur me sa mësipër, në kontekst të përmbushjes dhe plotësimit të kriterëve të përcaktuara, Komisioneri konstaton se:

Kandidatura e z.T.P, e për zgjedhur si kandidatë fituese nga ana e Ministres së MASR⁵-së, nuk plotëson kriteret e kërkuara dhe përcaktuara në aktet nënligjore, sipërcituar. Ky fakt, provohet nga verifikimi i dokumentacionit të z.T.P.

Konkretisht, lidhur me mosplotësimin e dy prej kriterëve të përcaktuara tek kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

1. Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
2. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

Nga këqyrja e dokumentacionit të z.T.P dhe CV-së së tij, rezulton se ai:

⁵ Referuar Urdhrit nr.329, datë 07.06.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.155, datë 13.03.2019 “Për lirimin nga detyra të anëtarëve të Bordit të Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe emërimin në detyrë të anëtarëve të rinj, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin”, të Ministrit të MASR.

- Ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve në programin “Master i Shkencave në të Drejtën Penale”, në vitin akademik 2017-2018.
- Si eksperiencë punësimi ka cituar se nga muaji Tetor 2018 dhe deri aktualisht, punon si Asistent Avokat pranë Zyrës së Avokatisë “Gurashi” Shkodër.
- Tek rubrika “Publikime Shkencore” ka cituar temat e trajtuara për mbrojtjen e Diplomës në Nivelin Bachelor dhe të Diplomës në Nivelin Master, si dhe një artikull të publikuar në Konferencën Shkencore Kombëtare.
- Tek rubrika “Trajnime” ka cituar se ka marrë pjesë në tre trajnime të organizuara nga Akademia Profesionale Elita.

Pra, në konkluzion të sa më sipër, shihet qartë se, kriteri që ai duhet të plotësonte, që të ketë minimum 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike; nuk plotësohet. Për rrjedhojë, as kriteri tjetër që të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.

Parë në rrafsh krahasues, subjekti ankues, haptazi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me z.T.P, pasi, nga këqyrja e dokumentacionit dhe CV-së së të tij, rezulton se ankuesi:

- Zotëron diplomën universitare Master në “Bankë dhe Financë”, Fakulteti i Ekonomisë/ Universiteti i Padovas, Itali.
- Sa i takon eksperiencës së tij në punë dhe përvojës profesionale, ai ka më shumë se 10 vite si pedagog i brendshëm në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, duke cituar në rend kronologjik:
 - Periudhën e stazhit 9-mujor në Bankën Antonveneta (seli qendrore në Padova), në zyrën e Traded Risk Management.
 - Specialist Buxheti pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe Pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Ekonomisë (USH) për periudhën Shtator-Dhjetor 2008.
 - Fitues në programin Brain Gain 27.03.2009.
 - Nga muaji Janar 2009 e deri aktualisht pedagog i brendshëm pranë Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Shkodrës.
 - Ka mbrojtur titullin “Doktor në Financë”⁶

⁶ Ka mbrojtur titullin “Doktor në Financë”, me temën: “Përdorimi i këmbesave në operacionet e mbulimit dhe vlerësimi i rrezikut të tregut nëpërmjet metodologjisë së vlerës në rrezik (VAR)”.

- Sa i takon publikimeve shkencore, vërehet se ka botuar 6 artikuj shkencorë në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka cituar 4 pjesëmarrje në konferenca brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Pra, nga sa verifikohet nga këqyrja e dokumentacionit të kandidatit të përzgjedhur si fitues, z.T.P dhe subjektit ankues, konstatohet se MASR ka shkelur haptazi dhe vetë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin e saj, nr.41, datë 24.01.2019. Po ashtu, në pikën e dytë të “Kërkesave të veçanta” që duhet të plotësojë kandidati, është cituar shprehimisht se “Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë”. Qartazi, ky kriter duhet të ishte marrë në konsideratë për vlerësimin e subjektit ankues, ndryshe nga z.T.P i cili krahasuar me ankuesin nuk e plotëson atë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, ankuesi, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, krahasuar me kandidaturën e z.T.P, nga ana e MASR.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁷, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

⁷“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se “*përkatësia në një grup të veçantë*” është shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ofron mbrojtje.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9⁸ të tij “*Ndalimi i diskriminimit*”, parashikon “*përkatësinë në një grup të veçantë*” si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, Komisioneri gjykon se “*përkatësia në një grup të veçantë*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë. Bazuar në shkresën me nr.extra prot., datë 21.11.2011 të Institutit të Përndjekurve Politike, subjekti ankues gëzon statusin e të përndjekurit politik.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

“*Përkatësia në një grup të veçantë*” përbën shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën,*

⁸ Me “*diskriminim*” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesi mbart shkakun e pretenduar. Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezulton se subjekti ankues gëzon statusin e të përndjekurit politik.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, krahasuar me kandidaturën e z.T.P, nga ana e MASR.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të

madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.⁹

Karta Social Europiane¹⁰ parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht.”*

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Karte do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”.*

Mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit në marrëdhëniet e punës e gjejmë të parashikuar edhe në *Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,* ku në interpretim të zgjeruar të saj, ndër të tjera përfshihet edhe mbrojtja nga diskriminimi për shkak të *“përkatësisë në një grup të veçantë”.*

Duke vijuar më tej, legjislacioni shqiptar e ka përforcuar mbrojtjen nga diskriminimi edhe nëpërmjet parashikimeve me karakter antidiskriminues në akte të tjera, ligjore. Neni 9, i Kodit të Punës¹¹, parashikon se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që*

⁹ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_iaw_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

¹⁰ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

¹¹ Përafuar pjesërisht me:

Direktivën e Këshillit 91/533/KEE, datë 14 tetor 1991, “Mbi detyrimin e punëdhënësit për të informuar punonjësit për kushtet e zbatueshme në kontratë ose në marrëdhënien e punësimin” . Numri CELEX 31991L0533, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 288, dt. 18. 10. 1991, f. 32 – 35.

Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000, “Mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion”. Numri CELEX 32000L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 303, dt. 2. 12. 2000, f. 16-22.

Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 5 korrik 2006, “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimin dhe profesionin”. Numri CELEX 32006L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 204, dt. 26. 7. 2006, f. 23-36.

bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me Hiv/Aids, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim.

Ligji nr. 10 221/2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “*Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e MASR nuk u arrit të provohej një përligjje e arsyeshme dhe objektive lidhur me vendimmarrjen e saj, për përzgjedhjen e kandidatues fituese të z.T.P.

Argumentimi i MASR se Vendimi për emërimin e z.T.P, si përfaqësues i studentëve në Bordin e Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, është bazuar plotësisht në nenin 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”, të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe në pikën 6, të VKM nr.782, datë 26.12.2018, nuk qëndron dhe është tërësisht i pabazuar.

Vërtet Vendimi i Ministres së MASR është një akt administrativ me natyrë diskreciale, por në rastin konkret është i paligjshëm, pasi ka shpërfillur vlerësimin dhe gjykimin e fakteve të rëndësishme që lidhen me kriteret që duhet të plotësoheshin nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit pranë IAL-ve, duke anashkaluar dhe shkelur dhe vetë kriteret e kërkuara dhe përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse të saj. (Urdhri nr.41, datë 24.01.2019 “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, i Ministres së MASR).

“Diskrecioni” nuk është arbitraritet, por duhet të ushtrohet brenda vlerësimit të autoriteteve dhe rregullave të arsyes dhe drejtësisë, dhe jo në përputhje me opinionin individual. Pra, vendimi i ndërmarrë nuk duhet të jetë arbitrar dhe jo transparent; por ligjor dhe të ushtrohet brenda kufijve për realizimin e një qëllimi të ligjshëm dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjatë shpërdorimit të diskrecionit, organi publik, kryen një paligjshmëri përmes mosrespektimit në mënyrë të gabuar ose të qëllimshëm të kufizimeve të brendshme ligjore, të dhëna për ushtrimin e diskrecionit¹².

Në rastin konkret, jemi përpara shpërdorimit subjektiv të diskrecionit, ardhur si rezultat i ushtrimit të diskrecionit të papërligjur dhe në shkelje të akteve nënligjore specifike, si dhe të pabazuar në rrethanat e faktet mbi të cilat duhej bërë kjo vendimmarrje.

Në kushtet kur, nga ana e MASR nuk u arrit të provohej që vendimmarrja e saj është e argumentuar dhe bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore specifike që lidhen me përzgjedhjen e kandidaturës fituese në Bordin e Administrimit të IAL-ve, dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e MASR, krahasuar me z.T.P, pikërisht për shkakun e pretenduar prej tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të Kodit të Punës nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹² M.P.Singh “German Administrative Law in Common Law Perspective”, fq 155

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të subjektit ankues, P. S, për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
2. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me vendimmarrjen e saj për përzgjedhjen e kandidaturës fituese të përfaqësuesve të studentëve në Bordin e Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

Fusha: Punësim

Shkaku: Përkatësi në një grup të veçantë